



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës
Ministarstvo Životne Sredine, Prostornog Planiranja i Infrastrukture
Ministry of Environment, Spatial Planning and Infrastructure

Zyra e Sekretarit të Përgjithshëm / Kancelarij Generalnog Sekretara / Office of the General Secretary

Nr.: 23/6208/MMPHI
Datë: 14.05.2025

Sekretari i Përgjithshëm i Ministrisë së Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës, në mbështetje të nenit 18 të Ligjit Nr. 06/L-113 për Organizimin dhe Funksonimin e Administratës Shtetërore dhe Agjencive të Pavarura, (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 7/01 Mars 2019), shtojcës 1 pika 10 të Rregullores (QRK) Nr. 02/2021 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, nenit 31 të Ligjit Nr. 03/L-025 për Mbrojtjen e Mjedisit, paragrafi 1, 2 dhe 4 të nenit 12 dhe nenit 13 të Udhëzimit Administrativ MMPHI Nr. 04/2022 për Leje Mjedisore, si dhe neni 9 paragrafi 1.4 i Udhëzimit Administrativ MMPH Nr. 04/2022 për Leje Mjedisore, nxjerr këtë:

V E N D I M

Operatori, "Peshk Istogu" Sh.p.k. Konjuh, Lipjan me nr. prot. 24/6208/MMPHI, i **ndërpritet procedura administrative** për pajisje me Leje Mjedisore për veprimtarinë: Kultivim, rritje, dhe shumim të peshku, në ngastrat nr. 862/1, 864/3, 864.4 dhe 864/5, zona kadastrale Komuna e Istogut.



Faqe 2 nga 4

Arsyetim

Pas pranimit të kërkesës për Leje Mjedisore nga operatori "Peshk Istogu" Sh.p.k. me nr. prot.24/6208/MMPHI, Istog, i **ndërpritet procedura administrative**, për veprimtarinë: Kultivim, rritje, dhe shumim të peshku, në ngastrat, nr. . 862/1, 864/3, 864.4 dhe 864/5, zona kadastrale Komuna e Istogut.

MMPHI ka kontrolluar dokumentacionin dhe në përputhje me nenin 10 paragrafi 3 të Udhëzimit Administrativ MMPH Nr. 04/2022, ka kërkuar nga operatori plotësim të dokumenteve si në vijim:

- Lejet ujore për shfrytëzim;
- Lejet ujore për shkarkim.

Operatori nuk ka sjell dëshmi për plotësimin e dokumentacionit të cekur me lartë.

Andaj bazuar në të cekurat më lartë, Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës, **ndërprenë procedurën administrative** në përputhje me nenin 10 paragrafi 3 të Udhëzimit Administrativ MMPH Nr.04/2022.

Shpjegim për palën: Dispozitivi i përcaktuar në vendim nuk sanksionon të drejtën e palës për ri aplikim sipas procedurës së rregullt.

Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Këshilla Juridike: Kundër këtij vendimi pala e pakënaqur mund të inicioj konflikt administrativ me padi, në Gjykatën Themelore, në afat prej 30 ditësh, nga dita e pranimit të këtij vendimi.





Izedin Bytyqi

U.D. i Sekretarit të Përgjithshëm i MMPHI-së

Vendimi i 'u dërgohet:

- Parashtruesit të kërkesës;
- Zyrës së Sekretarit të Përgjithshëm;
- Komunës- Istog;
- DMMU-së;
- Inspektoratit;
- Kabinetit të Ministrit
- Zyrës për komunikim me Publik të MMPHI-së;
- Arkivit të MMPHI-së.